

DIALOGU MEMEC I BILANCIT TË PAGESAVE: PASOJAT,
SHKAQET, REKOMANDIMET.

Altin Tanku

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

DIALOGU MEMEC I
BILANCIT TË PAGESAVE:
PASOJAT, SHKAQET, REKOMANDIMET

1. HYRJE

Në tetë vite tranzicion statistikat e bilancit të pagesave kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përshkrimin dhe parashikimin e zhvillimeve të pozicionit të jashtëm të ekonomisë shqiptare. Në tërësinë e statistikave ekonomike kjo kategori statistikore ka pasqyruar në detaje të konsiderueshme transaksionet ndërkombëtare të tregtisë së mallrave e shërbimeve dhe lëvizjet e kapitaleve. Në një ambient të përgjithshëm ekonomik të trazuar dhe në mungesën e disa kategorive të caktuara statistikore, statistikat e bilancit të pagesave kanë shërbyer si një tregues i rëndësishëm për përcaktimin e politikës monetare dhe të ndërhyrjeve në kursin e këmbimit. Statistikat e bilancit të pagesave luajnë një rol shumë të rëndësishëm si një indikator i gjendjes së ekonomisë, veçanërisht në ato vende, që ndjekin një politikë monetare të pavarur¹. Në një mënyrë a një tjetër ai ka qënë një test mbi efektshmërinë e politikave të ndjekura në ekonominë e brendshme. Treguesit e bilancit të pagesave luajnë një rol të shumëfishtë në analizat e hartuesve të politikave për zhvillimet ekonomike. Bilanci i pagesave ka, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në përshkrimin e zhvillimeve të pozicionit financiar të Shqipërisë.

2. Ç'ËSHTË BILANCI I PAGESAVE? TRAJTIMI I TIJ SI KATEGORI STATISTIKORE

Bilanci i pagesave mund të përshkruhet si një pasqyrë statistikore, që në mënyrë sistematike përmbledh transaksionet ekonomike të një ekonomie me pjesën tjetër të botës për një periudhë të caktuar kohe. Kjo statistikë, në Shqipëri, hartohet që prej vitit 1992 sipas kornizave metodologjike të përcaktuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në botimin e pestë të Manualit të Bilancit të Pagesave. Rrjedhimisht, konceptet, përkufizimet dhe klasifikimi janë në koherencë të plotë dhe përputhen me të gjitha kategoritë e tjera statistikore si për shembull ato të llogarive kombëtare.

Për të ruajtur këtë përshtatshmëri burimet e informacionit dhe metodikat e vlerësimit rishikohen rregullisht dhe shpesh janë prezantuar ndryshime periodike për t'iu afruar më shumë vlerësimit tonë me vlerat reale të transaksioneve me jashtë.

Transaksionet ekonomike, të paraqitura në bilancin e pagesave pasqyrojnë informacionin mbi shkëmbimet tregtare në fushën e mallrave dhe të shërbimeve, të ardhurave nga investimi i mjeteve financiare dhe transfertave pa shpërbim, të cilat së bashku përgjithësohen në konceptin e transaksioneve korente. Në shtesë të këtyre informacioneve, bilanci, pasqyron në detaje, lëvizjet e kapitaleve dhe të mjeteve financiare si dhe ndryshimet në rezervat valutore. I gjithë ky informacion statistikor, që lidhet me ndryshimin e vlerave ekonomike për një periudhë të caktuar kohe, i shpërndahe operatorëve në treg dhe të gjithë përdoruesve të tjerë në të njëjtën kohë dhe sipas të njëjtave standarde.

3. SI DHE ME SA VËRTETËSI I KA PARAQITUR BILANCI I PAGESAVE ZHVILLIMET E SEKTORIT TË JASHTËM?

Kjo është një pyetje thelbësore në kontekstin e cilësisë të këtyre statistikave. Për më shumë se tetë vjet përdoruesit kanë marrë në dorë statistika, të cilat megjithëse janë përpjekur të pasqyrojnë me vërtetësi atë që ka ndodhur në realitetin ekonomik kanë shfaqur edhe shenja, të cilat duket se kompromentojnë cilësinë. Problemet më të dukshme marrin formën e shifrave të larta në zërin "gabime dhe harresa", rishikimeve të shpeshta dhe jo rrallë në madhësi të konsiderueshme, vonesat në kohë, etj.. Duke marrë parasysh shumëllojshmëria e burimeve të informacionit dhe metodave të vlerësimit, të përdorura në hartimin e bilancit të pagesave është e vështirë që t'i referohesh një treguesi të vetëm, i cili mund të shërbejë si një matës i përgjithshëm i cilësisë së këtyre vlerësimeve. Për të vlerësuar cilësinë, që ofrojnë vlerësimet mbi ngjarjet reale të botës ekonomike, të cilave ato i referohen, përdoren dimensionet e mëposhtme sipas të cilave statistikat duhet :

- të jenë të sakta;
- të mos jenë subjekt i revizionimeve të mëdha;
- të publikohen në kohë të përshtatshme;

¹ Me politikë të pavarur monetare nënkuptojmë ato vende, politika monetare e të cilave nuk kushtëzohet nga kurset e lidhura të këmbimit apo fikse.

- të jenë të përshtatshme për përdorim;
- të përfaqësojnë të gjithë operatorët në treg;
- të jenë lehtësisht të disponueshme.

Në mënyrë ideale bilanci i pagesave duhet të hartohet duke mbledhur të gjitha transaksionet e të gjitha njësive ekonomike (qeveria, biznesi dhe individët) në Shqipëri me jorzidentët. Këto transaksione do të klasifikohen e do të shumohen për të dhënë tabelën e bilancit të pagesave. Nëse kjo do të mund të ndodhë në të vërtetë do të çonte në vlerën reale të bilancit të pagesave, por në praktikë kjo nuk mund të realizohet. Rrjedhimisht, cilësia e statistikave çënohet duke prekur veçanërisht dy përmasat e para.

Saktësia i referohet si koncept aftësisë me të cilën një vlerësim për një komponent të bilancit i afrohet vlerës së vërtetë të transaksioneve të atij komponenti. **Revizionimi** i referohet diferencave ndërmjet vlerësimeve fillestare për një periudhë të caktuar dhe vlerësimit final të transaksionit për këtë zë ose për këtë periudhë.

Në përgjithësi, me kalimin e kohës, vlerësimi për zërat e bilancit të pagesave kalon në rishikime të shumta kështu që nga ky proces përpiluesit mësojnë dhe me kalimin e kohës rishikimet bëhen gjithnjë e më të vogla pasi kjo lidhet direkt me saktësinë e vlerësimeve. Këta dy tregues kanë një korrelacion të fortë me rritjen e serisë kohore për çdo zë të bilancit, sa më e gjatë historia aq më i saktë vlerësimi dhe aq më i vogël rishikimi pasi këtu mund të futen në përdorim edhe metoda statistikore si ekstrapolimi i serive etj.. Një metodikë e tillë aplikohet zakonisht për respektimin e afateve kohore të publikimit, në rastet kur mungojnë të dhënat për periudhën në fjalë. Megjithatë, në vlerësimet e veta, Banka e Shqipërisë nuk e ka patur këtë luks, për arsye se në këto tetë vjet kemi akumuluar një historik relativisht të shkurtër e shumë të larmishëm të zhvillimeve të sektorit të jashtëm. Më poshtë po përmend disa prej shkaqeve, që prekin këto dy aspekte të cilësisë dhe që mendohet se kanë patur ndikim në rastin e Shqipërisë:

- Gabime në raportimin dhe në mbledhjen e të dhënave, që përfshijnë paaftësi të burimeve të informacionit për t'ju përgjigjur korrektësisht kërkesave për raportim; gabime në raportim ose raportime të vonuara nga burimet e të dhënave (disa herë këto gabime shkaktohen edhe nga përpjekjet e burimeve të informacionit për të respektuar afatet kohore të raportimit etj.); gabime të prezantuara në regjistrimin dhe në përpunimin e të dhënave të raportuara (shembuj këtu ka plot, për shembull rishikimi nga doganat për statistikën e reja, që vijnë ose raste të hedhjes së një zeroje më shumë ose më pak.)
- Gabime metodologjike, që rrjedhin nga keqinterpretimi i natyrës dhe shtrirjes së transaksioneve, statusit të rezidencës së palëve të përfshira në transaksion dhe, gjithashtu, prej mangësive të burimeve të të dhënave dhe të metodikave të vlerësimit.
- Mospërputhje në kohën e regjistrimit dhe në vlerën e regjistrimeve korresponduese të të njëjtit transaksion të bilancit të pagesave. Kjo rrjedh prej faktit se dy anët e një transaksioni (debita e kredia) sigurohen nga burime të ndryshme.
- Mospërfshirje e plotë e të gjitha transaksioneve si rrjedhim i vështirësisë për të identifikuar të gjitha njësitë e përfshira në transaksione dhe aktivitet ekonomik me jorzidentët për një periudhë të caktuar.
- Prezantimi i përmirësimeve në metodologjinë e bilancit të pagesave ose prezantimi i burimeve të reja të informacionit, të cilat i përfaqësojnë dhe i prezantojnë më mirë karakteristikat e zërave të veçantë të bilancit të pagesave e që, për rrjedhim, shoqërohen me rishikimin e të dhënave ekzistuese.

Raportimi në kohë i referohet hapësirës në kohë ndërmjet fundit të periudhës së referencës dhe publikimit fillestar të statistikave të bilancit të pagesave për këtë periudhë. Ekziston një kompromis i rëndësishëm, që bëhet ndërmjet saktësisë, rishikimit dhe detajimit nga njëra anë dhe shpërndarjes (publikimit) së statistikave, nga ana tjetër. Aktualisht, Banka e Shqipërisë duhet të publikojë statistikën e bilancit të pagesave dy muaj pas mbylljes së periudhës së referencës, por, shpesh, shumë prej të dhënave të rëndësishme nuk janë ende të vlefshme brenda kësaj periudhe. Të dhënat vijnë nga burime të ndryshme, janë të shumëllojshme dhe kanë frekuencë kohore të ndryshme nga frekuenca, që adopton Banka e Shqipërisë për statistikën e bilancit të pagesave. Për rrjedhim, statistikën e bilancit të pagesave mund të publikohen duke bërë lëshime mbi dy parimet e para të cilësisë.

Prandaj, duhet të mbahet parasysh se publikimi i statistikave tremujore është rezultat i një sërë kompromiseve për cilësinë e mund të rishikohen në periudhat që pasojnë. Në këtë këndvështrim, nevojitet kujdes nga ana e përdoruesve në interpretimin dhe në përdorimin e këtyre rezultateve fillestare për tremujorët përkatës.

Këto statistika, mund të konsiderohen të dobishme për ato qëllime analitike, të cilat kërkojnë indikatorë të përgjithshëm të zhvillimeve të sektorit të jashtëm, ndërsa statistikave vjetore janë më të përshtatshme për analiza më të detajuara për zëra të veçantë të bilancit të pagesave. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë nuk heziton dhe nuk harron asnjëherë të kujtojë përdoruesit në lidhje me këtë kufizim, në fund të çdo publikimi që bën për zhvillimet tremujore të bilancit të pagesave.

Mënyra e shpërndarjes së statistikave, aksesit i publikut dhe interpretimi si koncepte, i referohen lehtësisë me të cilën publiku mund t'i sigurojë këto statistika dhe përfshin lehtësinë e informimit si dhe sa e përshtatshme është forma e shpërndarjes. Veçanërisht këtu, Banka e Shqipërisë është shumë e avancuar në raport me kriteret e tjera të cilësisë, sepse statistikave e bilancit publikohen në gjashtë forma të ndryshme një prej të cilave është faqja e internetit të Bankës së Shqipërisë, që përfshin informacionin e pesë mënyrave të tjera.

Format e tjera i referohen deklaratave për shtyp mbi zhvillimet e sektorit të jashtëm, dhe botimeve periodike të Bankës së Shqipërisë dy prej të cilave janë të specializuara për statistikave e bilancit të pagesave. Ajo që është më e rëndësishme në marrjen e gjithë këtij informacioni nga publiku, është se përdoruesit nuk kanë asnjë kosto financiare për tu informuar pasi të gjitha këto publikime janë falas dhe mund të disponohen nga të gjithë të interesuarit.

Statistikave e publikuara janë të paraqitura në detaje dhe përmbajnë informacione plotësuese në formën e analizave, apo përshkrime metodologjike, të cilat në përgjithësi, mbulojnë konceptet kryesore të hartimit dhe të klasifikimit të çdo zëri me qëllimin për të ndihmuar interpretimin dhe përdorimin e përshtatshëm të statistikave të botuara nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, informacione të zgjeruara, përfshirë paraqitjen e rezultateve dhe analizën e tyre së bashku me komentet përkatëse, paraqitet në një ose disa prej këtyre botimeve për të gjitha vërtetimet statistikore ose për të gjitha informacionet e tjera shtesë mbi formatet e prezantuara tradicionalisht.

Analiza e mësipërme tregon qartë se, në historikun relativisht të shkurtër të kësaj statistike, Banka e Shqipërisë ka hasur vështirësi kryesisht në kënaqjen e dy koncepteve të para, që nënkupton probleme të saktësisë apo të mungesës së informacionit (kjo e fundit e shkaktuar edhe prej mbulimit të pjesshëm të operatorëve të tregut).

Pra, si konkluzion, cilësia e bilancit kompromentohet kryesisht prej problemeve, që lidhen drejtpërdrejtë me burimet e informacionit dhe me mangësitë e tyre. Natyrisht, që nuk do të ishte aspak korrekte të anashkalohet problemet që lidhen me metodologjinë, siç është problemi i rezidencës, por përvoja e Bankës së Shqipërisë tregon se këto probleme janë të eliminueshme përmes udhëzimeve praktike të dhëna nga Banka e Shqipërisë.

Të tilla probleme janë të parashikueshme dhe zgjidhjet për to sugjerohen në manualët e ndryshme të botuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga praktikave e vendeve të tjera. Pra, është e qartë se të gjitha problemet e cilësië lidhen dhe rrjedhin kryesisht prej burimeve të informacionit. Atëherë, cilat janë këto burime dhe përse nuk e kënaqin cilësinë e kërkuar të bilancit të pagesave?

Para se të kalohet në burimet e informacionit mendoj se është e rëndësishme të sqarohet **si jemi përpjekur ne të mbledhim informacionet e nevojshme për bilancin e pagesave**. Procesi i mbledhjes së informacionit është kompleks dhe i gjatë. Si fillim duhet të gesh se ku ndodhet ky informacion që kërkon, pastaj të bindet njësi që e ka se informacioni është i vlefshëm dhe pse duhet raportuar, dhe të punosh së bashku me të për ta nxjerrë e dizenuar si informacion, pa harruar që më pas të mbash lidhje të rregullta dhe miqësore për të siguruar vijueshmëri në raportime.

Në përgjithësi, Banka e Shqipërisë është përpjekur që mbledhjen e informacionit nga publiku (përfshirë të gjithë ata agjentë ekonomikë, që mund të kenë ose mund të sigurojnë informacione për bilancin e pagesave) ta konsiderojë si një proces bashkëpunimi, që në mënyrë figurative, në prezantimin e këtij materiali është quajtur "**dialogu i bilancit të pagesave**".

Ky është një proces që ka nisur në vitin 1992 me një marrëveshje ndërmjet disa institucioneve të Shtetit Shqiptar dhe në vitin 1995 është rregulluar dhe forcuar nga pikëpamja ligjore me një vendim të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit të gjitha institucionet zyrtare shtetërore, që kishin informacion për bilancin e pagesave bashkëpunonin në një komitet për këtë qëllim.

Më pas, duke vërejtur edhe problemet dhe mangësitë që ky rregullim nuk mundi t'i mbushte, u kalua në një detyrim më të fortë ligjor dhe kërkesa për raportim u përfshi në Ligjin për Bankën e Shqipërisë. Me keqardhje duhet pranuar se edhe ligji i la statistikave të pagesave aty ku i gjeti, pa prezantuar ndonjë efekt të dukshëm.

Megjithatë nuk dëshiroj të ndalem në mënyrën dhe eficiencën e funksionimit të ligjit, forcën e tij etj., sepse konferenca do të ndalet veçanërisht në këtë çështje, por jo vetëm për këtë arsye. Më tepër dëshiroj të mos ndalem, sepse në procesin e tërheqjes së informacionit Banka e Shqipërisë parapëlqen marrëdhëniet e mbështetura në mirëkuptimin, kënaqësinë, sigurinë dhe rezultatet, që ofron një bashkëpunim miqësor dhe i dobishëm për të dyja palët dhe jo në forcën e ligjit. Përvoja nuk lë dyshim se të dhënat e mbledhura në formën e parë janë më të sakta dhe më të vlefshme.

Për këtë qëllim, ne jemi kujdesur që në çdo rast, para se të kërkojmë një informacion, të përshkruajmë arsyet përse e kërkojmë këtë informacion, të tregojmë se garantojmë konfidencialitetin dhe në ato raste kur kemi menduar se është e vlefshme (për ata që janë kontaktuar) kërkesa është shoqëruar nga një publikim apo nga një tjetër produkt i gatshëm për statistikave të pagesave. E gjitha kjo, ka pasur si qëllim dhe mendojmë se ka shërbyer për t'u treguar përdoruesve se çfarë statistikash publikon Banka e Shqipërisë, pra për të tërhequr vëmendjen e për të ngjallur interes e njëkohësisht, për të treguar shkallën e agregimit në të cilën statistikave paraqiten në bilanc, për të shmangur frikën e konfidencialitetit.

4. BURIMET E INFORMACIONIT PËR BILANCIN SHQIPTAR TË PAGESAVE

Burimet e informacionit të përdorura për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave janë të shumta dhe, në përgjithësi, nuk ka një rregull të ngurtë që përcakton qartë dhe prerë burimet nga të cilat duhet të rrjedhë informacioni statistikor për bilancin e pagesave. Preferencat për përdorim variojnë nga njëri vend në tjetrin në varësi të karakteristikave të secilës ekonomi dhe të kuadrit ligjor e rregullativ, të adoptuar nga vende të ndryshme. Në praktikën tona për hartimin e bilancit të pagesave për sigurimin e informacionit statistikor përdoren burimet e mëposhtme:

1. Sistemi i raportimit të transaksioneve ndërkombëtare. Ky sistem nënkupton nxjerrjen e informacioneve prej regjistrimeve kontabël (arkëtimeve dhe pagesave) të sistemit bankar. Statistikat e ofruara nga ky burim janë aq të plota dhe përfaqësuese sa është i plotë edhe roli i bankave si ndërmjetëse në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, ndësa cilësia varet nga aspekte të veçanta të zhvillimit të sistemit bankar. Pra, në përgjithësi, informacioni i ofruar dhe cilësia e tij janë në varësi të drejtpërdrejtë të zhvillimit të sistemit bankar.

Kuptohet se ky burim gjeneron statistika të kënaqshme në ato ekonomi, ku bankat ndërmjetësojnë pothuajse të gjithë aktivitetin ekonomik.

2. Një burim i rëndësishëm është përdorimi i të dhënave zyrtare të publikuara nga autoritetet dhe institucionet shtetërore (përfshirë këtu edhe doganat apo INSTAT dhe të ashtuquajturin Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare) dhe ato prestigjioze joshetërore për shembull organizatat joqeveritare ose organizatat e biznesit si dhomat e tregtisë etj.. Në përgjithësi, në bilancin shqiptar të pagesave, këto burime informacioni sigurojnë të dhëna mbi aktivitetin dhe shkëmbimet tregtare e financiare të sektorit qeveri e përgjithshme dhe autoritetit monetar (Banka e Shqipërisë). Institucionet joqeveritare, që mbulojnë sektorët e tjerë të ekonomisë, në përgjithësi kanë një rol inekzistent, që rrjedh nga mungesa totale e statistikave nga këto institucione. Edhe në rastet kur këto institucione disponojnë ose gjenerojnë statistika, ato nuk janë të përdorshme për bilancin e pagesave ose për arsye, që lidhen me metodikat e përpilimit ose sepse nuk mbulojnë të gjithë operatorët e tregut gjë, që shpesh ndodh edhe me statistikave zyrtare.

3. Vrojtimet statistikore janë një mjet shumë i rëndësishëm për thithjen e informacioneve mbi transaksionet e bilancit të pagesave, që lidhen me aktivitetin e komunitetit të biznesit dhe të sektorit shtëpiak ose të individëve. Megjithëse të gjitha vendet mbështeten gjërësisht në dy burimet e trajtuara më sipër, të gjithë hartuesit e bilancit të pagesave i përdorin vrojtimit statistikore si një instrument të rëndësishëm për vjeljen e informacionit. Në raste të caktuara, vrojtimit përbëjnë të vetmen mundësi për të siguruar informacion (për shembull, si mund t'i masin flukset tregtare në mallra vendet e Komunitetit Europian, të cilat nuk kanë më kufij doganorë ndërmjet tyre, kur dihet se burimi kryesor i statistikave tregtare janë doganat?). Megjithëse konsiderohen një burim shumë i mirë informacioni, kryerja e vrojtimit statistikore është një proces shumë i vështirë dhe delikat. Ai kërkon përcaktimin e qartë të objektivave, pyetësorë të dizenuar mirë, përzgjedhje të popullatës së vrojtimit në mënyrë që të jetë sa më përfaqësuese, klasifikim dhe strukturë të mirëpërcaktuar të të dhënave statistikore, vlerësim të rezultateve dhe procedura agregimi efektive, etj..

4. Statistikat e vendeve partnere përbëjnë një burim të fuqishëm informacioni, jo vetëm në rastet kur nuk ka asnjë mundësi tjetër, por si një test për vërtetësinë e vlerësimeve të përdorura nga autoritetet vendase. Në këtë rast, i referohemi statistikave të vendeve partnere dhe statistikave të botuara nga organizatat ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, etj., për transaksionet ekonomike, që kanë pasur me Shqipërinë. Si burime të vlefshme informacioni mund të përmenden ambasadat e huaja, statistikat e botuara nga institucionet homologe në vendet partnere etj..

5. Shtypi në raste të caktuara mund të shndërrohet në një burim mjaft të rëndësishëm informacioni.

5. SI KA FUNKSIONUAR DIALOGU ME KËTO BURIME INFORMACIONI?

Është e qartë se, në përgjithësi, bashkëpunimi ka qënë i çalë, por për të qënë më të saktë duhet të ndalemi të trajtojmë dy kategori: së pari, rastet kur burimet e informacionit kanë vendosur një kontakt me Bankën e Shqipërisë dhe së dyti, rastet kur kërkesat tona kanë mbetur thirrje në shkretëtirë. Përgjithësisht, në rastet kur arrijmë të vendosim një bashkëpunim të llojit të parë, për ne do të thotë se është gjetur një zgjidhje e kënaqshme ose të paktën një fillim i mirë, por kjo nuk nënkupton (garanton) detyrimisht zgjidhje përfundimtare.

Shpesh, informacionet statistikore të ofruara prej dy ose më shumë prej këtyre burimeve janë kontradiktore dhe pa kuptim. Një problem tjetër i madh me këto burime statistikore është rishikimi i tyre, që jo rrallë shkakton luhatje jashtëzakonisht të mëdha edhe për faktin se statistikat e afuara nga këto burime, publikohen shumë vonë në kohë (në përgjithësi pas botimit të bilancit pagesave për periudhën korresponduese). Në rastin më ekstrem, këto statistika janë thjesht të papërdorshme për shembull, rasti i statistikave të vendeve partnere.

Pavarësisht nga problemet e mësipërme, ne jemi përpjekur t'i interpretojmë mangësitë si pamundësi të këtyre burimeve për të kënaqur ose kuptuar kërkesat e Bankës së Shqipërisë për informacion, por e kemi të vështirë të kuptojmë heshtjen e kategorisë të dytë.

Ky fenomen, në madhësi të ndryshme është i pranishëm në të gjitha burimet e përmendura të informacionit, por, prezantohet, veçanërisht i theksuar, në rastin e vrojtimeve statistikore me rezidentët. Në të kundërt, përvoja jonë tregon se jorezidentët kanë qënë shumë bashkëpunues në rastin e vrojtimeve statistikore. Përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të shfrytëzuar këtë burim për transaksionet e shërbimeve, të mallrave dhe të kapitalit (këtu të kihet parasysh vrojtimi për transportin ajror e atë detar, vrojtimi mbi tregtinë e jashtme, vrojtimi për shërbimet e turizmit, që rezidentët përfitojnë në udhëtimet e tyre jashtë shtetit dhe vrojtimi mbi investimet e huaja direkte) kanë dështuar, sepse, me përjashtim të rasteve shumë të rralla, të anketuarit kanë refuzuar të bashkëpunojnë dhe nuk janë përgjigjur. Ky proces, megjithëse pa rezultate të dukshme, ka qënë mjaft impenjativ për Bankën e Shqipërisë, e cila është përballur me një kosto të lartë në kohë në këtë proces (pasi angazhoi për këtë qëllim burimet e veta njerëzore).

Rrjedhimisht, në fund të vitit 1999 të gjitha përpjekjet në këtë drejtim u ndërprejnë duke adoptuar një strategji të re. Ndryshe nga më parë, Banka preferoi që të përballonte një kosto financiare duke "e blerë" kryerjen e vrojtimeve statistikore si shërbim nga një agjenci të specializuar në këtë drejtim. Dhe në fakt, pavarësisht nga ndonjë problem i vogël, duket se vrojtimet premtojnë të funksionojnë. Komenti i mësipërm i referohet konkretisht eksperiencave për vrojtimet statistikore mbi shërbimet e turizmit dhe tregtinë e jashtme, ndërkohë që është në projekt një vrojtim mbi investimet e huaja direkte. Rezultatet e këtyre vrojtimeve janë shfaqur ose do të shfaqen në statistikat e bilancit të pagesave për vitin 2000.

Sa për sistemin bankar nuk mjafton të përmendësh vetëm vështirësitë në ndarjen e transaksioneve të individëve nga transaksionet e ndërmarrjeve dhe klasifikimin e tyre sipas komponenteve standarte (zërave) të bilancit të pagesave, por, para së gjithash, duhet të kujtosh se jo të gjitha transaksionet ekonomike me jashtë kalojnë nga sistemi bankar.

Kjo nuk lejon mundësinë e krijimit të një sistemi të mbyllur ITRS, duke prekur direkt dimensionin e parë të cilësisë. Sipas vrojtimit të përmendur më lart për tregtinë e jashtme, rezulton se vetëm 36.4 për qind e transaksioneve të importit të mallrave kanalizohen nga sistemi bankar. Kjo shifër rritet deri në 44.5 për qind po të merren në konsideratë edhe transaksionet e eksportit.

Në mungesë ose për mangësi të theksuara të burimeve të përmendura më sipër Banka e Shqipërisë, sikurse edhe institucione të tjera, detyrohet të mbështetet në aplikimin vlerësimeve të arsyeshme për llogaritjen e zërave të veçantë të bilancit.

Rrjedhimisht, vlerësimet kthehen në “një burim” të pestë informacioni, nëse do të mund ta quanim kështu, vlera apo përdorimi i të cilit rritet në varësi të mangësive të sistemit statistikor në një vend me rritjen e aktivitetit ekonomik dhe zhvillimin e tregjeve informale. Përdorimi i vlerësimeve statistikore bëhet i domosdoshëm dhe zë një vend të rëndësishëm për vlerësimin zërave të veçantë ose axhustimin e vlerave të transaksioneve të raportuara nga burime të tjera (për shembull në rastin e kontrabandës në tregtinë e mallrave). Në statistikat tona vlerësimet përdoren kryesisht për llogarijen e dërgesave nga emigrantët, rritjen e mjeteve valutore (*cash-i* i mbajtur nga publiku në sektorin shtëpiak), korrigjimin e vlerës së transaksioneve të tregtisë së jashtme për vlerat e paregjistruara, llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për disa nga zërat e shërbimeve të transportit, investimet e huaja etj.. Duhet të theksohet, se për pjesën më të madhe të këtyre zërave, janë ndërmarrë vrojtime statistikore, të cilat kanë dështuar për shkak të mospërgjigjeve nga ana e të anketuarve duke dhënë rastin ekstrem të një dialogu memec.

Në Shqipëri, si pasojë e një sistemi të pazhvilluar statistikor dhe të shkallës relativisht të lartë, që besohet se ka tregu informal në aktivitetin ekonomik, përdoren të gjitha burimet e mundshme, nga statistikat bankare e deri te vlerësimet. Të gjitha këto burime përpiqen të mbushin njëri-tjetrin pa mundur të krijojnë një sistem të mbyllur informacioni për bilancin e pagesave.

Pas gjithë këtyre problemeve, që paraqet informacioni dhe bashkëpunimi i vakët për sigurimin e tij, ose në rastin ekstrem mosbashkëpunimi total, Banka e Shqipërisë është përpjekur të kuptojë shkaqet, të cilat e lënë këtë dialog memec. Natyrisht qëllimi ka qenë që, duke evidentuar faktorët të cilët kanë frenuar ose kanë penguar përgjigjet, t'i shmangë ata për t'i hapur rrugën zgjidhjeve dhe kompromiseve, që do të mundësojnë rrjedhjen e informacionit. Analiza jonë evidenton shkaqet e mëposhtme.

1. Neglizhenca. Ky është një fenomen, i cili, në madhësi të ndryshme, është vërejtur në të gjithë burimet e informacionit të përshkruara më lart. Heshtja disavjeçare e burimeve të veçanta mendoj se nxitet edhe nga fakti që informacione të rëndësishme disponohen prej institucioneve, objektivi ose qëllimi primar i punës së të cilave është shumë larg funksionit statistikor.

2. Konfidencialiteti. Burimet e informacionit i tremben rrjedhjes dhe keqpërdorimit të informacioneve të raportuara.

Shpesh, një fenomen i tillë shkaktohet edhe nga njësimi, që i bëhet Bankës së Shqipërisë me qeverinë apo autoritetet fiskale.

3. Raportimi nga disa institucione konsiderohet si punë angari dhe e kotë, ndërkohë që informacioni i kërkuar, fare mirë, mund të përdoret edhe prej tyre. Fakti se këto informacione të ofruara paraqiten më pas në statistikat dhe në botimet e veçanta të bilancit të pagesave në formën e analizës së rezultateve të vroitimit etj., i bën ato të përdorshme prej këtyre burimeve.

4. Dhënia e informacioneve ka kosto në kohë dhe në mjete financiare, e cila ndryshon ndërmjet burimeve të ndryshme të informacionit. Kërkesat e shumta, aq më tepër kur janë të përsëritura nga institucione të ndryshme për të njëjtin informacion ose informacione të pjesshme nga ato të raportuara më parë, natyrisht që shkaktojnë reagime negative, ndërkohë që përdoruesi i parë i këtij informacioni nuk e bën atë të disponueshëm për përdoruesit e tjerë.

5. Koordinimi i keq i punës, çon në keqpërdorimin dhe shfrytëzimin pa efektivitet të burimeve njerëzore dhe të atyre financiare. Jo rrallë, një vërtetim i bujqësisë, i transportit ose i turizmit i organizuar nga strukturat respektive ose INSTAT, me një ndryshim të vogël, mund të sigurojë informacion shumë të vlefshëm për bilancin e pagesave.

6. Arsye administrative, që lidhen me ndryshimin e stafit të institucioneve, me shkrirjen apo ndarjen e institucioneve apo thjesht të kompetencave të tyre, etj.. Siç është përshkruar më lart mbledhja e informacionit është proces i gjatë e i ndërlikuar dhe që bazohet në qëndrueshmërinë e lidhjeve me persona apo njësi të caktuara, të cilat në njëfarë mënyre shndërrohen në ekspertë të bilancit. Por, një ditë të bukur personi largohet ose njësia shkrihet apo i bashkëngjitet një institucioni tjetër dhe e gjitha kjo odise për informacionin duhet të fillojë nga e para me strukturën e re dhe nëse jemi me fat, mund ta marim përsëri informacionin e kërkuar.

7. Qëllimisht, diskutimi mbi cilësinë e statistikave më lart u ndërpre pa mbaruar, sepse para se të mbyllet përfundimisht ky problem mbetet pa u trajtuar matësi i fundit i cilësisë së një statistike dhe konkretisht **Sa Mirë i Përgjigjet Një Statistikë Nevojave Të Përdoruesve Të Vet**. Preferoj të ndalem më shumë në këtë të fundit dhe ta theksoj me forcë, pasi mendoj se kjo është një nga faktorët kryesorë, që garanton statistika të mira sipas të gjithë parametrave cilësorë të përshkruar më lart.

Sot, për shumë nga prodhuesit e statistikave zyrtare në botë koncepti më përgjithësues për cilësinë merr formën e mëposhtme:

Cilësia e statistikave i referohet në të gjitha aspektet se sa mirë kjo statistikë përmbush nevojat e përdoruesve dhe pritjet e tyre për informacion statistikor pasi ajo i është dhënë këtij publiku për konsum.

Natyrisht, në kuptimin më të drejtpërdrejtë, përcaktimi të lë të kuptosh se një statistikë e keqe nuk përdoret nga publiku. Por, po me të njëjtën vërtetësi, ky përcaktim fsheh edhe një pohim tjetër të thënë heshturazi e që me fjalë të tjera do të thotë se sa i interesuar të jetë publiku për statistika aq më të mira janë ato. Statistikat, në përgjithësi, dhe bilanci i pagesave si pjesë e tyre, ka një histori shumëvjeçare në botë. Bilanci i pagesave ka lindur si një llogari e thjeshtë eksport-importi dhe transaksioneve në ar ndërmjet shteteve dhe, gradualisht, është shndërruar në një kategori statistikore. Historia, e zgjerimit ka nisur nga nevoja për më shumë informacion. Mekanizmi i zgjerimit është vënë në lëvizje nga nevojat e përdoruesve, të përfshirë në analizat makroekonomike e financiare në formulimin e politikave tregtare e të kursit të këmbimit, në formulimin e politikave ekonomike etj.. Ajo që dua të them është se çdo rresht i shtuar në bilanc (çdo informacion i kërkuar apo i detajuar) ka ardhur si nevojë e përdoruesve të tij, sepse në fund të fundit informacioni është kërkuar për t'u vënë në shërbim të përdoruesit.

Në kuptimin relativ, në një vend ku publiku ushtron presion për statistika të mira edhe statistikat do të jenë të tilla. Ku qëndron përfitimi pas këtij presioni? Së pari, përfitimi qëndron në faktin se kush ka kërkesa të larta për statistika të mira e cilësore do të detyrohet të japë edhe informacion të mirë. Kushdo, që njeh rëndësinë e statistikave dhe ka nevojë për to, nuk mund të neglizhojë dhënien e informacionit pasi këto janë si dy hallka të një zinxhiri të pashkëputur. Së dyti, interesimi i publikut mbi aspekte apo transaksione të veçanta mund të konsiderohet si një sinjal i mjaftueshëm për objektivat drejt të cilave duhet të përqëndrohet rritja e cilësisë. Pra, ndryshimi i parë fillon me konceptin dhe qëndrimin mbi statistikat, kush i përdor dhe i njeh ato (për shembull e di se nuk ka përse të trembet për konfidencialitetin) do të jetë i gatshëm t'i japë informacionet. Por, nga ana tjetër, nëse publiku nuk është i interesuar për statistika, nuk reklamon kërkesat e veta dhe nuk i përdor ato, atëherë edhe statistikat nuk do të jenë të mira.

Kështu ndryshimi i dytë ka të bëjë me rishikimin që publiku duhet t'i bëjë rolit të vet mbi zhvillimet statistikore, sepse askush më mirë se ai nuk e di se cilat janë kërkesat e tij.

Teorikisht, përdoruesit e bilancit të pagesave duhet të jenë të gjithë ata persona, të cilët duhet të marrin vendime ekonomike. Në praktikë është e vështirë të kuptosh se cilët janë përdoruesit dhe në çfarë mase i përdorin statistikat e bilancit të pagesave.

Megjithatë, gjithmonë në funksion të idesë së dialogut, do të përpiqem të përshkruaj përdoruesit, por duke i renditur në një rend zbritës sipas presionit, që ushtrojnë mbi Bankën e Shqipërisë për statistikat e bilancit të pagesave. Duke nënkuptuar me presion kërkesën për statistika, dhe shpjegime e analiza mbi këto statistika, shpjegime mbi metodologjinë e zërave të veçantë, sugjerime apo korrigjime mbi elemente të veçanta etj..

- Autoriteti monetar;
- organizatat ndërkombëtare FMN. WB. etj.;
- kabineti qeveritar dhe institucione të tjera shtetërore;
- disa nga vendet partnere;
- sistemi bankar;
- organizatat joqeveritare dhe institucionet kërkimore shkencore;
- komuniteti i biznesit;
- individët.

Në krye të listës, natyrisht, qëndrojnë **autoritetet monetare** të vendit, të cilat janë njëkohësisht edhe prodhueset e kësaj statistike. Rrjedhimisht, kërkesa është e dyfishtë edhe për qëllime të përdorimit edhe për kërkesë llogarie.

Në institucionet shtetërore përfshihet **kabineti qeveritar**, kryesisht ato pjesë, që janë të angazhuara në procesin e vendimmarrjes dhe të hartimit të politikave ekonomike, në përgjithësi, ose në fusha të caktuara.

Nevojat kryesore dhe më të përgjithshme të këtyre përdoruesve orientohen nga përcaktimi dhe hartimi i politikave monetare dhe atyre të sektorit të jashtëm në kuadrin e programeve të zhvillimit. Vëmendja e tyre fokusohet kryesisht mbi treguesit më të përgjithshëm të bilancit të pagesave.

Vendet partnere. Këtu natyrisht nuk përfshihen të gjitha, por ato më kryesoret. Kërkesat nga këto vende bëhen kryesisht prej ambasadave të tyre në Tiranë, natyrisht informacionet që kërkojnë i referohen transaksioneve tregtare në mallra e shërbime me vendet të cilat ato përfaqësojnë.

Institucionet joqeveritare dhe ato kërkimore, në përgjithësi, kanë një kërkesë shumë të vakët për informacion, i cili duket se shërben vetëm për plotësimin e disa tabelave në kuadrin e projekteve të këtyre organizatave.

Shtypi, ky përdorues shpesh të shkakton dhimbje koke me analizat e gabuara me ose pa qëllim, duke shkaktuar më shumë disinformim dhe probleme të tjera të këtij lloji.

Komuniteti i biznesit dhe individët. Këto grupe rezultojnë se nuk përpiqen të vendosin asnjë lloj kontakti me Bankën e Shqipërisë për të kërkuar statistika, aq më pak për të ushtruar atë që më lart e kemi quajtur presion. Në përgjithësi, mund të thuhet se tregu është mjaft indiferent kundrejt këtyre statistikave dhe duket se, atëherë, kur komuniteti i biznesit përfiton nga statistikave të bilancit të pagesave, kjo ndodh vetëm aksidentalisht. Vetëm së fundmi, nëpërmjet organizatave, të cilat përfaqësojnë komunitetin e biznesit ka filluar të ketë një presion në formën e kërkesës për informacion (thjesht për të marë publikimet) por edhe në këtë rast informacioni duket sikur përdoret në kuadrin e projekteve të ndryshme të këtyre organizatave dhe nuk përthypet drejtpërdrejt nga biznesi.

Po në të vërtetë a ka çfarë të përfitojë biznesi nga këto statistika? Natyrisht që po. Statistikat e bilancit të pagesave ofrojnë një informacion më të madh dhe më të detajuar se ai që japin bilancet tregtare e ato korente. Në transaksionet e paraqitura në zërat e llogarisë korente jepen të ardhurat dhe shpenzimet për fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik. Duke paraqitur bilancin ndërmjet të ardhurave dhe shërbimeve në transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve ai, njëkohësisht, përcakton ecurinë apo zhvillimin në kohë të gjendjes së detyrimeve dhe të pretendimeve kundrejt pjesës tjetër të botës. Rezultatet e transaksioneve korente dhe lëvizjet e flukseve të kapitalit, mund të shërbejnë si indikatorë të mirë për pritshmërinë e investitorëve të huaj mbi të ardhmen e ekonomisë, në tërësi, si dhe të degëve të veçanta. Lëvizjet dhe zhvillimet në bilancin e pagesave ndërthuren shumë - dhe njëkohësisht shërbejnë si indikatorë - mbi veprimet dhe pritshmërinë e të gjithë pjesëmarrësve të tregut në një ekonomi të hapur.

Njëkohësisht, ai reflekton vendimet e rezidentëve dhe të jorezidentëve, sjelljen e tyre në lidhje me investimet, kursimet, konsumin, pozicionin fiskal, faktorët demografikë etj..

Veçanërisht, botimet speciale (kryesisht prezantimi i rezultateve të vrojtimit statistikore) janë një burim shtesë informacioni pasi ato përmbajnë informacione e analiza të detajuara në një drejtim të caktuar ose për një aktivitet të caktuar dhe shoqërohen me statistika dhe analiza të hollësishme për këto aktivitete. Duke mbledhur të dhëna e duke publikuar rezultatet, banka (nëse mund të thuhet kështu) bën rolin e një agjencie konsulente nëpërmjet të cilës bizneset mund të gjejnë se ku ndodhen ato në raport me një vlerësim të përgjithshëm të degës. Prandaj, duke shfrytëzuar rastin e dhënë nga kjo konferencë, ftoj veçanërisht biznesin, që të luajë një rol më aktiv në përmirësimin e cilësisë të statistikave përmes rritjes së kërkesës për informacion dhe gatishmërisë për ta dhënë atë.

6. KONKLUZIONE

Statistikat vërtet nuk janë themeli i asaj shoqërie, që ne duam të ndërtojmë, por janë një element shumë i rëndësishëm, në rrugën e transformimit të shoqërisë dhe të ekonomisë. Ato kanë rëndësi jo vetëm për të kuptuar ndryshimet dhe për të projektuar të ardhmen, por edhe për të prezantuar në mënyrë serioze e të besueshme ekonominë shqiptare në botë.

Cilësia e statistikave të bilancit të pagesave, aktualisht, çënohet kryesisht nga saktësia, rishikimi dhe mbulimi i pjesshëm i operatorëve të tregut, duke identifikuar si problemin kryesor informacionin dhe burimet e tij.

Nëse mund të shprehemi në mënyrë figurative, Banka e Shqipërisë ka dalë në treg për të blerë statistika. Në përgjithësi, morali që prodhon ky fenomen është se mund të kesh dëshirë, mund të përpiqesh, mund të kesh njohuri të kënaqshme metodologjike, por shpesh këto nuk gjenerojnë rezultatet e dëshiruara nëse nuk shoqërohen nga buxhete të mjaftueshme financiare.

Cilësia e statistikave nuk mund të rritet dhe statistikave të mira nuk mund të merren nëse publiku nuk i sheh statistikave të bilancit të pagesave si të nevojshme për përdorim në procesin e vendimarrjes. Vetëm atëherë kur ai të ushtrojë "presion" mbi prodhuesit e tyre do të mundësohet përmirësimi.

Nëse nuk ka dialog ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe përdoruesve cilësia e kësaj statistike do të mbetet e rrezikuar. Përdoruesit kanë një rol kryesor në përmirësimin e statistikave të bilancit të pagesave duke i dhënë jetë dialogut në dy mënyra. Së pari, duke iu përgjigjur kërkesave për raportim nga banka dhe së dyti, duke kërkuar më shumë cilësi në statistikave të bilancit të pagesave, që do të thotë rritje e presionit mbi Bankën e Shqipërisë. Gjithkush që di, ka informacion ose thjesht dyshon se një shifër e prezantuar është gabim, është i mirëpritur të hapë dialogun, të njoftojnë dhe të identifikojnë edhe vendin ku mund të gjendet informacioni i saktë për të etj..

7. REKOMANDIME

Në historinë e gjatë të statistikave të bilancit të pagesave hartuesit e tij janë përpjekur të arrijnë të njëjtin objektiv në mjedise të ndryshme në varësi të karakteristikave specifike, që përfaqëson çdo ekonomi. Në varësi të këtyre veçorive janë propozuar metodika të ndryshme për llogaritjen dhe për vlerësimin e transaksioneve ekonomike të përfshira në statistikave të bilancit të pagesave. Për rrjedhim, në rastet kur vlerësimi i transaksioneve të veçanta nuk mund të sigurohet nga një burim informacioni, përvojat botërore garantojnë një varg propozimesh të vlefshme. Duke shfrytëzuar këto përvoja dëshiroj të bëjë tre rekomandime.

1. Mbledhja e bilanceve kontabël të të gjitha njësive ekonomike në një dhe vetëm një institucion. Më pas ky institucion mund të shndërrohet në një burim informacioni për të gjithë përdoruesit e këtij informacioni, që mund të jenë agjenci të ndryshme shtetërore, të cilat sot e kërkojnë këtë informacion secila më vete. E njëjta skemë mund të aplikohet edhe në raste të tjera të ngjashme. Një skemë e tillë paraqet përparësi sepse së pari, lehtëson biznesin duke eliminuar dhënien e të njëjtit informacion në dy ose më shumë përdorues. Së dyti, garanton të dhëna për të gjitha institucionet që kanë nevojë për këto informacione, por që për arsye të ndryshme nuk mund të ushtrojnë presion direkt mbi biznesin. Së treti, kjo do të garantonte përdorimin e të njëjtit informacion për qëllime të ndryshme.

2. Përdorimi nga bankat i kodit të nomenklaturës së veprimtarive ekonomike (instat) për çdo klient. Rrjedhimisht, kjo do të lehtësonte shumë (natyrisht duke bërë kompromisin se të gjitha arkëtimet dhe pagesat e një njësie ekonomike lidhen me aktivitetin e vet kryesor) punën për klasifikimin arkëtimeve dhe të pagesave, që lidhen me transaksionet e këtyre njësive me jorezidentët.

3. Periudha e tranzicionit është ndikuar vazhdimisht nga fenomene të veçanta si tregtia e jashtme joformale në periudhën 1994-1995, shkëlqimi dhe rënia e skemave piramidale në periudhën 1996-1997, kriza kosovare e vitit 1999, fenomeni "skafe" që garanton transportin ilegal të njerëzve dhe mallrave etj.. Të gjitha këto ngjarje dhe fenomene kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin e sektorit të jashtëm², efektet e të cilit duhet të përfshihen në vlerësimet e aplikuar për zëra të veçantë të bilancit të pagesave. Natyrisht, Banka e Shqipërisë ka bërë vlerësimet e veta për të pasqyruar ndikimin ekonomik të këtyre fenomeneve në statistikave të saj, por Shteti Shqiptar ka struktura të caktuara që ndjekin ose trajtojnë këto fenomene, të cilat kanë dhe disponojnë një informacion më të gjerë për efektet e mundshme ekonomike të këtyre fenomeneve. Në këtë kuadër, mendoj se një transparencë më e madhe nga këto struktura, kuptohet pa cënuar objektin e punës së tyre, do të ishte në të mirë të statistikave të bilancit të pagesave.

² Sipas analizave personale mendoj se janë një ndër shkaktarët kryesorë të shifrave të larta pozitive të zërit "Gabime dhe Harresa" për vitet në fjale.